



**Autoriteti Shtetëror për
Informacionin Gjeohapësinor**



**Universiteti Bujqësor
i Tiranës**

Nr. 282/1 Prot., Tiranë, më 04.06.2025

Nr. 493 Prot., Tiranë, më 02.06.2025

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

ndërmjet

AUTORITETIT SHTETËROR PËR INFORMACIONIN GJEOHAPËSINOR

dhe

UNIVERSITETIT BUJQËSOR TË TIRANËS

Tiranë, sot më datë 02.06.2025, nënshkruhet kjo marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet palëve si më poshtë vijon:

Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG), institucion publik qendror, me NIPT L31919452G dhe adresë: Rruga "Papa Gjon Pali II" Nr. 3, 1010 Tiranë, i krijuar me ligjin nr. 72/2012, datë 28.06.2012, "Për organizimin dhe funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë", **përfaqësuar nga Drejtor i Përgjithshëm Znj. Vilma TOMÇO**, këtu e në vazhdim "ASIG"

dhe

Universitetit Bujqësor të Tiranës, me adresë në Kodër-Kamëz, Tiranë themeluar në vitin 1951 si Instituti i Lartë Bujqësor, sot i njohur si Universiteti Bujqësor i Tiranës, qendra e vetme e formimit Universitar, kërkimit shkencor, trajnimit dhe këshillimit në fushën e bujqësisë dhe ushqimit, **përfaqësuar nga Rektori Prof. Dr. Fatbardh Sallaku**, këtu e në vazhdim "UBT".

Këtu e më poshtë, ASIG dhe UBT individualisht referuar si "Palë" dhe së bashku "Palët".

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje është të përcaktojë dhe të formalizojë kuadrin e bashkëpunimit ndërmjet Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor dhe Universitetit Bujqësor të Tiranës, në funksion të:

- a) përdorimit dhe shkëmbimit sa më efikas të informacionit ndër institucional;
- b) forcimit të kapaciteteve të burimeve njerëzore, nëpërmjet përgatitjes së specialistëve të rinj në përputhje me prioritetet e zhvillimit kombëtar;
- c) përmirësimit të cilësisë së ekspertizës kërkimore dhe integritit të saj me procesin e mësimdhënies;
- d) promovimit të përdorimit të teknologjisë bashkëkohore në fushën e gjeoinformacionit.

Neni 2

Baza ligjore

Kjo marrëveshje është hartuar në përputhje me ligjin nr. 72/2012, datë 28.06.2012, “Për organizimin dhe funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjin nr. 80/2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë”, Statutin e UBT-së të miratuar me Urdhrin nr. 586, datë 02.12.2024 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

Neni 3

Fusha e Bashkëpunimit

Për përmbushjen e qëllimit të kësaj Marrëveshjeje, fushat e bashkëpunimit ndërmjet Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor dhe Universitetit Bujqësor të Tiranës do të përfshijnë, por nuk do të kufizohen në, këto veprimtari kryesore:

1. **Angazhimi i përbashkët në projektin “Krijimi i Qendrës së Gjeoinformacionit për Zhvillim të Qendrueshëm në Ballkanin Perëndimor”**, si dhe identifikimi, nxitja, mbështetja dhe realizimi i projekteve të tjera të përbashkëta me interes të ndërsjellë në fushën e gjeoinformacionit;
2. **Zbatimi i projekteve kërkimore kombëtare dhe ndërkombëtare**, duke përfshirë organizimin e përbashkët të konferencave, simpoziumeve, seminareve, kurseve, workshopeve dhe formave të tjera të bashkëpunimit akademik dhe shkencor në fushën e gjeoinformacionit;
3. **Nxitja dhe realizimi i veprimtarive të përbashkëta** në fushën e arsimit të lartë, formimit profesional, trajnimit dhe kërkimit shkencor;

4. **Shkëmbimi i njohurive**, përfshirë literaturë profesionale, tekste mësimore dhe botime universitare, si dhe të dhënave që avancojnë interesin e ndërsjellë të palëve, në përputhje me rregullat dhe politikat e brendshme të secilës palë;
5. **Shkëmbimi i materialeve dhe rezultateve të punës studimore dhe kërkimore**, në përputhje me parimet e konfidencialitetit dhe mirëbesimit ndërmjet palëve;
6. **Rrjetëzimi dhe shkëmbimi i ndërsjellë i stafit akademik dhe kërkimor**, përfshirë mësimdhënës, studiues, studentë dhe personel tjetër, me qëllim përmirësimin e mësimdhënies, zhvillimin e kurrikulave dhe punës kërkimore-shkencore;
7. **Krijimi i hapësirave institucionale për zhvillimin e trajnimeve** sipas nevojave të ndërsjella të palëve;
8. **Sigurimi i hapësirave për zhvillimin e praktikave profesionale dhe mësimore** për studentët e UBT-së në fushën e gjeoinformacionit, si dhe udhëheqja e përbashkët e projekteve të ndryshme kërkimore, përfshirë temat e disertacioneve të doktoraturës;
9. **Informimi në kohë dhe në mënyrë të përshtatshme** ndërmjet palëve, në funksion të përmbushjes së detyrimeve të marrëveshjes dhe ndarjes së zhvillimeve institucionale që përbëjnë interes të ndërsjellë;
10. **Organizimi dhe zhvillimi i aktiviteteve të përbashkëta kombëtare dhe ndërkombëtare**, në përputhje me qëllimet dhe objektivat e kësaj Marrëveshjeje;
11. **Zhvillimi i një komunikimi efektiv ndërmjet palëve** për koordinimin dhe realizimin e projekteve apo iniciativave të tjera me interes të përbashkët.

Neni 4

Përgjegjësitë dhe të Drejtat e Palëve

1. Palët angazhohen të bashkëpunojnë për realizimin e praktikave mësimore dhe projekteve të përbashkëta, duke vënë në dispozicion kapacitetet e tyre njerëzore, teknike dhe institucionale, për të mundësuar zhvillimin e këtyre aktiviteteve në përputhje me qëllimet e kësaj Marrëveshjeje dhe nevojat akademike.
2. Palët përcaktojnë në mënyrë të përbashkët numrin e studentëve pjesëmarrës në praktika, periudhën e zhvillimit, kohëzgjatjen dhe përmbajtjen orientuese të programeve përkatëse, duke respektuar kapacitetet organizative dhe objektivat mësimore të secilës palë.
3. Në kontekstin e projekteve bashkëpunuese midis ASIG dhe Universitetit Bujqësor të Tiranës, Qendrës së Gjeoinformacionit për Zhvillim të Qendrueshëm në Ballkanin Perëndimor, si dhe institucioneve të tjera partnere, të dyja palët angazhohen zyrtarisht për shkëmbimin reciprok të të dhënave gjeo-relevante (shërbimin e mbulimit me imazhe satelitore), si dhe informacione të tjera në interes reciprok.
4. ASIG angazhohet të mirëpresë studentët e përzgjedhur për zhvillimin e praktikës mësimore, t'i asistojë dhe trajnojnë në përputhje me programet e miratuara, si dhe të sigurojë, kur kërkohet, vlerësime për ecurinë e tyre akademike dhe profesionale.
5. ASIG rezervon të drejtën të ndërpresë zhvillimin e praktikës, për individë të veçantë ose për të gjithë grupin, në rastet kur konstatohen shkelje të kushteve të dakortësuara ose sjellje që çenojnë mbarëvajtjen e punës institucionale. Vendimi për ndërprerjen bëhet në koordinim me UBT-në dhe me njoftim paraprak me shkrim.

6. UBT angazhohet të informojë zyrtarisht ASIG-un për programin e praktikave mësimore, ta njohë atë si partner zyrtar në këtë proces dhe, kur është e nevojshme, të ofrojë asistencë për studentët në ambientet e ASIG-ut para fillimit të praktikës.
7. UBT angazhohet të propozojë dhe përfshijë ASIG-un si partner në projektin “Krijimi i Qendrës së Gjeoinformacionit për Zhvillim të Qendrueshëm në Ballkanin Perëndimor” e cila është në proces regjistrimi pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me synim forcimin e kapaciteteve profesionale në fushat e Sistemeve të Informacionit Gjeografik (GIS), teknologjisë Remote Sensing dhe analizës së të dhënave gjeohapësinore, si dhe në çdo projekt tjetër të mundshëm me interes të ndërsjellë.
8. UBT merr përsipër të vërë në dispozicion të ASIG-ut rezultatet e punës kërkimore-shkencore të realizuara në kuadër të bashkëpunimit ndërmjet palëve.
9. Palët angazhohen të kontribuojnë në mënyrë të ndërsjellë në përmirësimin e kapaciteteve të autoriteteve publike në fushën e menaxhimit të informacionit gjeohapësinor, në përputhje me misionin dhe kompetencat e tyre institucionale përkatëse.

Neni 5

Rregullime të Përgjithshme dhe Aspektet Financiare

1. Për çdo veprimtari që përputhet me frymën dhe objektivat e kësaj Marrëveshjeje, palët mund të zhvillojnë konsultime dhe të bien dakord mbi mënyrën konkrete të realizimit të bashkëpunimit, në përputhje me kapacitetet përkatëse institucionale.
2. Kjo Marrëveshje nuk krijon detyrime financiare të menjëhershme për asnjërën nga palët dhe nuk shoqërohet me impakt buxhetor ndërmjet tyre.
3. Në rast se, gjatë zbatimit të kësaj Marrëveshjeje, lind nevoja për financimin e projekteve të përbashkëta, palët do të formalizojnë marrëveshje të veçanta financiare, në të cilat do të përcaktohen qartë kushtet, detyrimet dhe kontributet financiare të secilës palë. Këto marrëveshje do t'i bashkëlidhen kësaj Marrëveshjeje si anekse shtesë.
4. Palët angazhohen të ruajnë dhe të respektojnë integritetin institucional të njëra-tjetrës, në përputhje me parimin e barazisë, partneritetit dhe mirëbesimit reciprok.

Neni 6

Kohëzgjatja e Marrëveshjes

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi lidhet pa afat të përcaktuar dhe hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit nga të dyja palët, duke prodhuar efektet juridike përkatëse prej datës së nënshkrimit.

Neni 7

Konfidencialiteti

1. Secila palë e kësaj Marrëveshjeje angazhohet të mos bëjë publike, të mos përhapë dhe të mos komunikojë tek palë të treta asnjë informacion, dokumentacion apo të dhënë të lidhur me veprimtarinë e zhvilluar në kuadër të kësaj Marrëveshjeje, si dhe çdo informacion tjetër që nuk është i njohur nga publiku në momentin e marrjes së tij (“Informacion Konfidencial”), përveç rasteve kur ekziston miratimi paraprak me shkrim i palës tjetër.

2. Secila palë angazhohet të përdorë Informacionin Konfidencial vetëm për qëllime që lidhen me zbatimin e detyrimeve të përcaktuara në këtë Marrëveshje dhe për asnjë qëllim tjetër, personal ose institucional.
3. Palët angazhohen të ruajnë konfidencialitetin e të dhënave sensitive dhe personale, si dhe të respektojnë privatësinë e informacionit të shkëmbyer gjatë bashkëpunimit, duke i administruar ato në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale dhe informacionit të klasifikuar.
4. Detyrimi i ndërsjellë për konfidencialitetin do të vazhdojë të mbetet në fuqi dhe pas përfundimit të kësaj Marrëveshjeje sipas parashikimit të nenit 5 të saj, ose për aq kohë sa informacioni nuk është bërë publik në mënyrë të ligjshme.

Neni 8

Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

1. Çdo mosmarrëveshje që mund të lind ndërmjet palëve lidhur me interpretimin, zbatimin ose moszbatimin e kësaj Marrëveshjeje, apo të çdo akti apo dokumenti tjetër të lidhur në zbatim të saj, do të tentohet të zgjidhet me mirëkuptim dhe dialog konstruktiv ndërmjet palëve.
2. Në rast se palët nuk arrijnë një zgjidhje me mirëkuptim, mosmarrëveshja do t'i nënshtrohet shqyrtimit nga **Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë**, e cila do të ketë kompetencën përfundimtare për zgjidhjen e saj.

Neni 9

Personat e Kontaktit

Për garantimin e efikasitetit të procedurës së komunikimit dhe bashkëpunimit të vazhdueshëm, palët përcaktojnë si persona kontakti zyrtarë:

Për Universitetin Bujqësor të Tiranës:
Person Kontakti: Prof. Dr. Erinda Lika
E-mail: elika@ubt.edu.al

Për Autoritetin Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor:
Person Kontakti: Z. Dritan Prifti, Drejtor i Drejtorisë së Përpunimit të të Dhënave Remote Sensing
E-mail: Dritan.Prifti@asig.gov.al

Çdo ndryshim i personave të kontaktit do të njoftohet me shkrim palës tjetër brenda një afati 5-ditor nga momenti i ndryshimit.

Neni 10
Dispozita përfundimtare

Çdo njoftim, komunikim, ndryshim, shtesë apo plotësim që lidhet me këtë Marrëveshje Bashkëpunimi dhe që mund të lindë gjatë zbatimit të saj, do të kryhet në formë të shkruar (shkresore) dhe do të përcillet përmes kanaleve zyrtare të komunikimit ndërmjet palëve.


Marrëveshja hartohet në dy (2) kopje origjinale, në gjuhën shqipe, me vlerë të barabartë ligjore, nga të cilat secila palë mban nga një kopje.

PËR
AUTORITETIN SHTETËROR PËR
INFORMACIONIN GJEOHAPËSINOR

DREJTORI I PËRGJITHSHËM

Znj. Vilma TOMÇO

Nënshkrimi _____



PËR
UNIVERSITETIN
BUJQËSOR TË TIRANËS

REKTORI

Z. Fatbardh SALLAKU

Nënshkrimi _____

